



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS DHE SPORTIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 723 Prot.

Tiranë, më datë 30.12.2025

VENDIM

Nr. 650, datë 30.12.2025

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 "Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale", Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 "Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj", pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 30.12.2025:

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Ministrisë së Turizmit, Kulturës dhe Sportit për rivlerësimin e Vendimit të KKTKM-së nr. 565, datë 20.11.2025, për projektin "Ndërhyrje restauruese në fasadën e objektit "Hotel Internacional në rrugën Kajo Karafili", Monument Kulture Kategorisë II-të, me aplikues dhe zhvillues **Z. Eduard Kelmendi**;
2. Të vijojë faza e punimeve vetëm për ndërhyrjet restauruese në fasadën e objektit "Hotel Internacional në rrugën Kajo Karafili", Monument Kulture Kategorisë II-të;
3. Gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikëqyren sipas Ligjit Nr. 27/2018 "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë", neni 72, pika 1 dhe 2;
4. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
5. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi;
6. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Endri HAXHIU

